

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"AMPERA AL" Sh.p.k**

**I.       THEMELIMI**

**NENI 1  
Ortaket themelues**

Shoqeria krijohet nga ortaku themelues:

- Z. Arian Kastrati , shtetas kosovar, lindur më 04/07/1989 në Prishtinë , Kosovë , identifikuar me pashaporten me numër P00874467 dhe me numër identifikimi 1170093174, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

**II.       EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI**

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqeria emertohet **"Ampera Al" Sh.p.k**

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite Tregtare".

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqeria **"Ampera Al" Sh.p.k** e ka seline e saj ne adresen: Tirane , Njesia bashkiake nr 5 , Rruga "Ymer Kurti" , Qendra e biznesit 'Olympia" , Kati 2 , Zyra nr 1.

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorëve të **"Ampera Al" Sh.p.k**.

**NENI 5  
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria **"Ampera Al" Sh.p.k** ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë "Ampera AI" Sh.p.k, do të ketë për objekt: Import-eksport dhe tregtim të gjithave llojeve të materialeve elektrike dhe të energjise. Instalime elektrike të gjitha llojeve.

5.3 Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.4 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

### **III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQËRISË-VENDIMARRJA**

#### **NENI 6**

#### **Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

#### **NENI 7**

#### **Kapitali i Shoqërisë**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë "Ampera AI" Sh.p.k përfaqësohet nga 1 (një) kuote me vlerë totale 1,000,000 (një milion) leke e cila nuk është paguar.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:

- Z. Arian Kastrati : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1,000,000 (një milion) leke që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **NENI 8**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet që ligji apo Statuti ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen në një regjister të posaçëm të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë "Ampera AI" Sh.p.k.

8.2 Janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi, shndërrimi i shoqërisë;
- zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar nga vete shoqëria me qëllim anulimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel të autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblesë

**NENI 9**  
**Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

**NENI 10**  
**Administratori i Shoqërisë**

10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, person fizik që mund të jetë ose jo ortak i Shoqërisë.


10.2 Administratori është të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qendrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pese) vjetesh.

10.4 Administratori e parë të shoqërisë emerohet:

Z. Arian Kastrati , shtetas kosovar, lindur më 04/07/1989 në Prishtinë , Kosovë , identifikuar me pasaportën me numër P00874467 dhe me numër identifikimi 1170093174 , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar I cili emerohet për një periudhë 5 (pese) vjetecare.

Nënshkrimi i administratorit \_\_\_\_\_



10.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

**NENI 11**  
**Ligji i zbatueshem dhe mosmarreshjet**

11.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, referencë i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

11.2. Për të gjitha mosmarreshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortaku themelues

**ORTAKU THEMELUES**

**Z.Arian KASTRATI**

**Data: 30/05/2024**

ARIAN KASTRATI

